



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:074391

Datë: 26.04.2019

Numri i dokumentit: 00292780

P.nr.115/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit A. J. nga fshati R... Komuna e V..., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.120/2019, të datës 29.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.04.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A... J..., nga babai S.... dhe nëna F...., e lindur H...., i lindur me datë...., në Gj...., me vendbanim në fshatin R...., Komuna e V....., student, i pa martuar, i punësuar si kamarier në restorantin “Rona” në Prishtinë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.01.2019, rreth orës 17:30 minuta, te P.... e fshatit L...., i pandehuri ...pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që i njëjti në momentin që është ndaluar dhe kontrolluar nga ana e zyrtarëve policor, është konstatuar se posedon substancë narkotike të llojit M..... në sasi prej...., ashtu që i pandehuri me veprimet e tij pa leje dhe pa autorizim ka poseduar substancë narkotike.

-Me çka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 i KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehuriti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 pika 2.7, nenit 69 dhe nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-së, të pandehurit të lartcekur i shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që nga i pandehuriKONFISKOHET substanca narkotike e llojit “.....”, në peshë prej....., e cila pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t’ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetë e pesë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 29.01.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.120/18, kundër të pandehurit,..... për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me par. 1 i KPRK-së.

Më datë 17.04.2019, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuri..... Në këtë seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç’ rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuri....., pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehurika kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, nuk kryer ndonjë veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njejtë është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij dhe ka kërkuar falje për veprimet e tij, po ashtu gjykata mori parasysh faktin se i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njejtë bie ndesh ligjin dhe se dhe se i njejtë është i gjendjes së varfër ekonomike dhe edhe pse është i ri në moshë i njejtë është mbajtës i familjes së tij 5 anëtarëshe ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se përdorimi i substancave të ndaluara me ligj është bërë dukuri e shpeshtë në shoqërinë tonë.

6.Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues

Gjykata duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7, dhe nenin 275 paragrafi 3 të KPRK-ës, të pandehurit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues përkatësisht konfiskimin me të cilin dënim të njejtë i ka konfiskuar substancën narkotike të llojit “.....”, në sasi preje cila të pandehurit i ishte sekuestruar nga ana e policisë, e cila substancë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t’ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t’i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetë e pesë euro), në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.115/19, me datë 17 Prill 2019

Procesmbajtësja,
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.